



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

Nr. 23, datë 04.10.2024

**PËR
RISHIKIMIN E KUSHTEVE TË LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“PARKU FOTOVOLTAIK 5GX ENERGY SOL PARK”,
ME VENDNDODHJE NË BASHKINË E LUSHNJES**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “5gx energy” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Rishikimin e kushteve të Lejes së Ndërtimit për objektin “Parku Fotovoltaik 5GX Energy Sol Park”, me vendndodhje në Bashkinë Lushnje, të miratuar me Vendimin Nr. 13, datë 26.12.2023 të Këshillit Kombëtar të Territorit, me subjekt zhvillues shoqërinë “5gx energy” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur Vendimit Nr. 13, datë 26.12.2023 “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Parku Fotovoltaik 5GX Energy Sol Park”, me vendndodhje në Bashkinë Lushnje, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INERASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 24/01 / 2025